

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil priti në një takim Drejtoreshën e Departamentit të Administratës Publike

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Leterije Lleshi (Luzi), zhvilloi një takim pune me Drejtoreshën e Departamentit të Administratës Publike (DAP), znj. Vilma Guri, me fokus forcimin e bashkëpunimit institucional dhe rritjen e kapaciteteve të administratës publike.



Gjatë takimit u diskutuan hapa konkretë për përmirësimin e menaxhimit të shërbimit civil, rritjen e profesionalizmit dhe garantimin e zbatimit të standardeve ligjore në administratë. Theksi u vendos te koordinimi i proceseve që lidhen me zbatimin në praktikë të ligjit “Për nëpunësin civil”, si dhe te përmirësimi i mekanizmave të monitorimit dhe shkëmbimit të informacionit.



Palët u angazhuan për ngritjen e grupeve të përbashkëta të punës dhe për rinovimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, me objektiva të qartë, në funksion të një administrate publike më efikase, transparente dhe në shërbim të qytetarëve.